



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 20.9.2016

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 463, DATË 22.9.2011, “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, TË NDRYSHUAR”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar”, nismë e një grupi deputetësh, në mbledhjen e datës 13 korrik dhe 20 shtator 2016.

Projektligji synon riejimin e importit për mbetjet e ngurta jo të rrezikshme të listës së gjelbër, si lëndë e parë dytësore, për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e industrisë ricikluese të vendit, për qëllime riciklimi dhe përdorimi si zëvendësues, të lëndëve të tjera nga burime jo të rinovueshme.

Në vitin 2013 u ndalua importi i mbetjeve për arsye riciklimi pasi institucionet përkatëse nuk ishin në gjendje të inspektonin cilësinë e mbetjeve për shkak edhe të mungesës së laboratorëve përkatës.

Aktualisht në Shqipëri operojnë disa industri, nevojat e të cilave për lëndë të parë siç mund të jenë mbetjet e listës së gjelbër, nuk përmbushen nga mbetjet e krijuara në vend kështu që është një kërkesë e vazhdueshme dhe e pranuar që nga viti 2003 importimi i këtyre mbetjeve në bazë të procedurave e rregullave të forta.

Në mungesë të importit asnjë industri riciklimi nuk do të ishte konkurruese në treg dhe asnjë nuk do të investonte në industri të tilla duke sjellë kështu edhe pamundësinë e riciklimit të mbetjeve të gjeneruara në vend.

Riciklimi siguron lëndë të parë duke kontribuar në menaxhimin më të mirë të burimeve natyrore, si dhe duke kontribuar me lëndë të parë në ato vende të cilat nuk i kanë ato lloj burimesh. Në rast se nuk lejohet riciklimi i mbetjeve, atëherë të gjitha industritë duhet të bazohen në shfrytëzimin ekstensiv të burimeve natyrore të lëndëve të para, duke çuar në shterimin e plotë dhe më të shpejtë të burimeve ekonomike. Kjo shkel parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë njerëzore, shkel parimin që brezave të ardhshëm ne u lëmë një trashëgimi më pak, ose mundësi më të kufizuara për të ndërtuar progresin e tyre.

Riciklimi gjeneron vende pune. Kjo industri krijon biznese të reja si ato që lidhen me transportin, përpunimin dhe shitjen e materialeve të ricikluara, si dhe kompani që lidhen me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të prodhuara me materiale të ricikluara. Si rrjedhim krijohen vende pune dhe shtohen të ardhurat në buxhetin e shtetit.

Meqenëse këto mbetje i nënshtrohen analizave specifike në laboratorë tashmë të ngritur, eliminohet rreziku i futjes së mbetjeve të rrezikshme.

Parashikimet kryesore të projektligjit, pas përmirësimeve të bëra në Komision, janë si më poshtë:

- Në Republikën e Shqipërisë ndalohet importi i mbetjeve jo të rrezikshme, për qëllim ruajtjeje, asgjësimi ose incenerimi.
- Në Republikën e Shqipërisë lejohet të importohen vetëm mbetjet e ngurta, jo të rrezikshme, të listës së gjelbër, si lëndë e parë dytësore, për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e industrisë ricikluese të vendit, për qëllime riciklimi dhe përdorimi si zëvendësues, të lëndëve të tjera nga burime jo të rinovueshme, që përdoren nga industria.
- Autorizimi për importin e mbetjeve jo të rrezikshme është i vlefshëm për një periudhë kohe deri në dy vjet dhe lëshohet nga ministri përgjegjës për mjedisin. Nisma e re propozon që autorizimi për import mbetjesh do t'i jepet vetëm atyre subjekteve të cilat janë licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së riciklimit dhe që posedojnë infrastrukturë riciklimi.
- Transparenca ka qenë një tjetër element që nuk ka funksionuar siç duhet në procesin e importit të mbetjeve dhe për këtë arsye projektligji parashikon që Këshilli i Ministrave ndër të tjera të miratojë edhe rregullat e transparencës në lidhje me importin e tyre.
- Me qëllim fokusimin dhe forcimin e kapaciteteve dhe logjistikës për mbikqyrjen e importit të mbetjeve është parashikuar që procesi i kontrollit dhe zhdoganimit përfundimtar të mbetjeve të kryhet në jo më shumë se tre pika doganore.
- Forcimi i sanksioneve për personat që importojnë mbetje të rrezikshme apo mbetje të parrezikshme në kundërshtim me autorizimin e dhënë është një tjetër risi e projektligjit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni zhvilloi seanca dëgjimore me grupet e interesit të ricikluesve dhe me pjesëtarë të shoqërisë civile, shoqata ambientalistësh e ekspertë të ndryshëm të mjedisit.

Në reflektim të shqetësimeve të tyre, Komisioni ka bërë disa përmirësime në projektligj si:

- ndalimi i importit të mbetjeve jo të rrezikshme për qëllime incenerimi;
- përcaktimi i rregullave të transparencës në lidhje me importin e lejuar të mbetjeve, të cilat do të miratohen nga Këshilli i Ministrave;
- forcimi i mbikqyrjes së importit të mbetjeve të lejuara, duke fokusuar kapacitetet teknike e njerëzore vetëm në tre pika doganore; etj.

Ky projektligj pritet të rivitalizojë industrinë vendase të riciklimit duke kontribuar kështu edhe në hapjen e shumë vendeve të punës dhe shtimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen u bënë ndryshimet si më poshtë:

1. **Neni 1** të ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Në nenin 22 pika 3 shfuqizohet.”

2. **Në nenin 2, shkronja “b”** të ndryshohet si më poshtë:

“b) Pas pikës 2 shtohet pika 3 si më poshtë:

“3. Ndalohet importi i mbetjeve jo të rrezikshme, për qëllim ruajtjeje, asgjësimi ose incenerimi në Republikën e Shqipërisë.”

3. **Neni 3** të ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Pas nenit 48, shtohet neni 48/1 me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 48/1

Importi i mbetjeve jo të rrezikshme

1. Në Republikën e Shqipërisë importohen vetëm mbetjet e ngurta jo të rrezikshme, të listës së gjelbër, si lëndë e parë dytësore, për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e industrisë ricikluese të vendit, për qëllime riciklimi dhe përdorimi si zëvendësues, të lëndëve të tjera nga burime jo të rinovueshme, që përdoren nga industria, përveç atyre të përcaktuara në pikën 3 të nenit 48 të këtij ligji.

2. Procesi i kontrollit dhe zhdoganimit përfundimtar i mbetjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet në jo më shumë se në tre pika doganore që kanë kapacitetet teknike dhe njerëzore për monitorimin e tyre. Këto pika caktohen nga Ministri përgjegjës për Financat dhe Ministri përgjegjës për Mjedisin.

3. Importimi i mbetjeve, sipas pikës 1 të këtij ligji, është i mundur vetëm me autorizim të ministrit.

4. Kërkesa për autorizimin e importit paraqitet në ministri.

5. Autorizimi i importit të mbetjeve jo të rrezikshme, sipas pikës 1 të këtij neni, lëshohet vetëm në përputhje të plotë me këtë ligj dhe akte të tjera në fuqi.

6. Autorizimi për importin e mbetjeve jo të rrezikshme, sipas pikës 1 të këtij neni, është i vlefshëm për një periudhë kohe deri në dy vjet dhe i jepet vetëm atyre subjekteve të cilat janë licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së riciklimit dhe që posedojnë infrastrukturë riciklimi. Autorizimi i nënshtrohet kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në rregulloret e miratuara në zbatim të këtij ligji, si dhe çdo kushti specifik që lidhet me rastin konkret.

7. Në autorizimin e importimit të mbetjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen:

a) lloji i mbetjeve për importin e të cilave lëshohet;

b) standardet që lidhen me ambalazimin dhe etiketimin e mbetjeve dhe dokumentet shoqëruese gjatë transportit të tyre;

c) kërkesat për monitorimin dhe raportimin e lëvizjeve të mbetjeve.

8. Kërkuesi i autorizimit të importit të mbetjeve jo të rrezikshme duhet të provojë se janë shfrytëzuar të gjitha mbetjet , sipas llojit dhe kodit.

9. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton listën e mbetjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, që lejohen të importohen dhe rregullat për zbatimin e këtij neni, si dhe rregullat e transparencës në lidhje me këtë import.

10. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat dhe procedurat, për importimin mbetjeve për përdorim, përpunim, riciklim dhe si zëvendësues, për zbatimin e këtij neni.”

4. Në nenin 4, shkronja “a” të ndryshohet si më poshtë:

“a) Pika 48 riformulohet si më poshtë:

"48. Çdo person që importon mbetje të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 500 000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë."

5. Në nenin 5 të bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

- a) referenca të ndryshohet si vijon: “...në zbatim të pikës 9 dhe 10 të nenit 3 të këtij ligji”;
- b) të shtohet një pikë e dytë si vijon: “2. Ngarkohet Ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për mjedisin që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 3 të tij.

Besnik BARAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar